

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Politikë “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7643, datë 02.12.1992 “Për Inspektimin Sanitar”, të ndryshuar
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Nuk synon përafrim me legjislacionin e Bashkimit Europian
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Ligji nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, të ndryshuar.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	22.10.2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	01.11.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	08.11.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MSHMS - 06
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Bora Kola bora.kola@shendetesia.gov.al ; +355696684984 Ervina Lila ervina.lila@shendetesia.gov.al ; +355693620066
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?</i> Ligji Nr.7643, datë 02.12.1992, “Për Inspektimin Sanitar”, i ndryshuar, është ligji bazë i cili rregullon kontrollin për përmbushjen e kushteve higjieno-sanitare në funksion të shëndetit publik, i cili përfshin shumë fusha dhe faktorë që ndikojnë për ruajtjen e tij si një e mirë publike. Në ligjin aktual përcaktohet Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (këtu e në vijim: struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit) si organi që kontrollon zbatimin e akteve ligjore, nënligjore me objekt inspektimin e ruajtjes së kushteve higjieno-sanitare në veprimtaritë e ndryshme që ushtrojnë personat fizikë, juridikë, publikë dhe jopublikë. Në kuadër të reformës në bujqësi dhe me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, bazuar në rregulloren e BE 178/2002, 854/2004, 888/2004, i cili rregullon çështjet e higjienës dhe sigurisë së ushqimit, është krijuar Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (këtu e në vijim: institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit) dhe një sistem i kontrollit formal për ushqimin e njerëzve, kafshëve me qëllim garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, interesit të konsumatorit. politikë Me miratimin e akteve të lartpërmendura është krijuar mbivendosje ndërmjet kompetencës për inspektim higjieno-sanitar në objektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportit dhe tregimit të produkteve ushqimore nga institucioni	

përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

- Ndarja e qartë e kompetencave ndërmjet strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë brenda vitit 2020 dhe mbrojtja e shëndetit publik nëpërmjet inspektimeve higjieno-sanitare të kryera nga institucionet përgjegjëse.
- Ndërmarrja e procedurave administrative përkatëse për kalimin e inspektorëve nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit te institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë brenda vitit 2020, me qëllim fuqizimin e institucioneve.
- Eliminimi i inspektimeve të dyfishta, brenda vitit 2020, në bizneset që operojnë në fushën e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore, me qëllim lehtësimin e bizneseve nga barra ekonomike dhe sociale.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për të realizuar objektivat janë marrë në konsideratë opsionet e mëposhtme:

Opsioni 0, ruajtja e status quo-së implikon mbajtjen në fuqi të ligjit aktual. Ky opsion lë të parregulluar ndarjen e qartë të kompetencave mes dy institucioneve, institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit për inspektimin në objektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore. Ndarja e paqartë e kompetencave mes dy institucioneve ka ardhur si rrjedhojë e reformës në bujqësi dhe ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.

Opsioni 1, hartimi i një ligji të ri. Nuk është një opsion i preferuar, pasi problemet e sipër përmendura në lidhje me inspektimin e produkteve ushqimore mund të adresohen me ndryshime të ligjit aktual dhe ndërhyrja nuk bën ndryshime thelbësore të ligjit dhe mënyrës së inspektimit. Në shqyrtimin e opsionit më të mirë u mor në konsideratë se Ligji Nr.7643, datë 02.12.1992, “Për Inspektimin Sanitar”, është ndryshuar disa herë (konkretisht, 5 herë) dhe ky është ndryshimi i tij i 6^{të}. Megjithatë hartimi i një ligji të ri inspektimi është i nevojshëm kur parimet e inspektimit, mënyra e organizimit dhe e funksionimit të strukturave që do të kryejnë inspektim ndryshon rrënjësisht, pra do të ndodhë një organizim i ri i formatit të inspektimit dhe jo një riorganizim i thjeshtë, synimi i të cilit është kalimi de jure i një kompetence që de facto ushtrohet nga të dy institucionet përgjegjëse për inspektim, për të njëjtin qëllim.

Opsioni 2, bërja e ndryshimeve në ligjin aktual përfshin ndarjen e qartë të kompetencave

për inspektimin higjieno-sanitar ndërmjet institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit lidhur me inspektimet në objektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Asnjë nga opsionet nuk ka ndikim me vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin e shtetit. Si rrjedhojë e ndarjes së qartë të kompetencave ndërmjet institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit, lehtësohen bizneset nga inspektimet e dyfishta lidhur me produktet ushqimore.

Kalimi i kompetencave nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit te institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë do të sjellë edhe ristrukturimin organizativ të dy institucioneve, duke kaluar disa inspektorë të strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit te institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Kalimi i inspektorëve do të kryhet në bazë të vlerësimit të përbashkët të Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duke u bazuar në volumin e punës së shtuar si rrjedhojë e reformimit të procesit të inspektimeve. Reformimi i procesit të inspektimeve duke kaluar kompetencën e inspektimeve nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit te institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, për kategori të caktuara të bizneseve, do të sjellë edhe ristrukturimin organizativ të dy institucioneve, duke ulur barrën inspektuese për bizneset dhe nga ana tjetër, forcohen kapacitetet administrative të të dy institucioneve. Kalimi i inspektorëve sipas këtij paragrafi nuk shoqërohet me kosto shtesë në buxhetin e shtetit.

Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit do të fuqizohet sepse burimet njerëzore do të fokusohen në inspektimin shëndetësor, inspektimin sanitar jo ushqimor, si edhe në inspektimin dhe monitorimin për zbatim të:

- Ligjit nr. 9518 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”, të ndryshuar;
- Ligjit nr. 9636 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar;
- Ligjit nr. 26/2017 “Për Produktet Kozmetike”;
- Ligjit nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”;
- Ligjit nr.8528, datë 23.9.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gj” të ndryshuar;
- Ligjit nr. 8025, datë 09.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” të ndryshuar.

Si rrjedhojë e ndarjes së qartë të kompetencave mes institucioneve do të përditësohen shkeljet administrative sanitare dhe masat e dënimeve kryesore të vendosura nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit.

Ndarja e qartë e kompetencave lehtëson barrën e bizneseve që operojnë në këtë fushë sepse shmangen inspektimet e dyfishta për të njëjtin qëllim: plotësimin e standarteve të cilësisë

dhe sigurisë së produkteve ushqimore dhe garantimin e shëndetit publik.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni 2, ose bërja e ndryshimeve në ligjin aktual është opsioni i preferuar i politikës. Kjo politikë nuk ndryshon mënyrën e inspektimit higjieno-sanitar por qartëson ndarjen e kompetencave mes strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë në objektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore, për shkak të mbivendosjes së kompetencave që janë krijuar pas reformës në bujqësi dhe miratimit të Ligjit Nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.

Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
0	0	0

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7643, datë 02.12.1992, “Për inspektimin sanitar” të ndryshuar”, është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike më datë 22.10.2019.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi i ligjit është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit.

Aktualisht institucionet përgjegjëse për inspektimin në objektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore janë struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Ndarja e kompetencave të këtyre institucioneve shmanë mbivendosjen dhe lehtëson bizneset nga inspektimet e dyfishta.

Konkretisht, struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit kryen mesatarisht 42 000 mijë inspektime vjetore, në të cilat mbulohen inspektimi shëndetësor dhe inspektimi sanitar. Inspektimi sanitar përfshin inspektimin në objektet e prodhimit, të ruajtjes, magazinimit, transportimit e tregtimit të produkteve ushqimore dhe inspektimin sanitar në objekte të tjera joushqimore.

Gjatë vitit 2018 struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit ka kryer 42 046 inspektime dhe monitorime. Sipas tematikës dhe fushës së veprimtarisë këto kategorizohen:

- 83 % e numrit të përgjithshëm ose 34 898 inspektime dhe monitorime janë kryer në

fushën shëndetësore dhe sanitare jo në fushën e ushqimit, (në subjekte shëndetësore, arsimore, turistike, kozmetike, në ato të Ministrisë së Rendit, Ministrisë së Mbrojtjes etj)

- Pjesa tjetër e inspektimeve, 17 % ose 7 148 janë inspektime në objektet e prodhimit, të ruajtjes, magazinimit, transportimit e tregtimit të produkteve ushqimore.

Në strukturën organike të miratuar me Urdhër të Kryeministrit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka 202 inspektorë, nga të cilët 67 janë inspektorë sanitarë. E konvertuar në numër punonjësish pesha e inspektimit sanitar ushqimor në një vit llogaritet:

Për 67 inspektorë sanitarë, 17% e volumit të punës së tyre shkon për inspektimin sanitar në fushën e ushqimit, që do të thotë e barabartë me ngarkesën e punës së 11 inspektorëve, ndërsa 83% e volumit të inspektimeve shëndetësore, inspektimeve për ligjet specifike dhe inspektimet sanitare jo ushqimore, e përkthyer me peshën e punës të 56 inspektorëve duke llogaritur se inspektori sanitar është pjesë përbërëse e grupeve të inspektimit në institucionet shëndetësore dhe inspektimeve për ligje specifike.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- Jepni kontekstin e politikës

Ligji Nr. 7643, datë 2.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar, është ndër ligjet e para të miratuara pas periudhës së diktaturës, për shkak të rëndësisë që ka përmbushja e rregullave higjieno-sanitare me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga faktorët e dëmshëm për shëndetin. Kontrolli i përmbushjes së kushteve higjieno-sanitare nga të gjithë subjektet publike dhe jopublike është realizuar kryesisht nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit.

Me anë të reformës në bujqësi dhe ndryshimeve të legjislacionit në fushën e ushqimit, të kërkuar për shkak të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, u krijua Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, bazuar në Ligjin “Për Ushqimin” Nr. 9863, datë 28.01.2008 dhe VKM Nr. 1081, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë) ka për qëllim të vendosë bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesat e konsumatorit, duke përcaktuar kërkesat dhe parimet e përgjithshme për higjienën dhe sigurinë e ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë dhe detyrimet e operatorëve të biznesit të ushqimeve dhe të ushqimeve për kafshë për higjienën dhe sigurinë e këtyre ushqimeve. Kjo ka sjellë mbivendosje të kompetencave ndërmjet strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Kjo mbivendosje ka sjellë barrë të paarsyeshme në bizneset që operojnë në fushën e prodhimit, të ruajtjes, magazinimit, transportimit e tregtimit të produkteve ushqimore, të cilët janë inspektuar nga dy institucione të ndryshme për të njëjtin qëllim: ofrimi i sigurisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore për mbrojtjen e shëndetit publik.

Ligji Nr. 7643, datë 2.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, ka pësuar ndryshimeve ndër vite, konkretisht, Ligji Nr. 7904, datë 8.3.1995, Ligji Nr. 9635, datë 6.11.2006 dhe Ligji Nr. 45/2013.

Gjithashtu, pika 3, pika 4 dhe pika 5, e nenit 72, e Ligjit nr.9863 datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, ka shfuqizuar pjesërisht ose plotësisht nenet 13, 19 dhe 20 të Ligjit Nr.7643, datë 2.12.1992 “Për inspektimin sanitar”.

Ndryshimi i parë që ju bë ligjit bazë për inspektimin sanitar ka ndodhur me anë të Ligjit Nr. 7904, datë 8.3.1995, ku përveçse ngarkoi Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për nxjerrjen e akteve nënligjore bëri dhe ndryshime në nenin 26, pika 2, në fund të paragrafit ku u shtuan fjalët: "Kur këto ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut" dhe pikën 10, e cila u riformulua si: "Ndotja e burimeve dhe e objekteve të tjera të ujit të pijshëm dhe derdhja e ujërave të institucioneve të ndryshme pa u dezinfektuar ose dezaktivizuar". Gjithashtu, ky ligj preku dhe ndryshime lidhur me llojet e shkeljeve administrative në fushën higjieno-sanitare.

Me anë të Ligjit Nr. 9635, datë 6.11.2006, u bëri shtesa në përkufizimet e termave kryesore të inspektimit sanitar si “shëndet publik”, “shëndet mjedisor”, “siguri ushqimore” etj. Ai ndryshoi dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shëndetit Publik në Ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë. Me anë të këtij ligji, u arrit që ndërmarrjet, institucionet shtetërore e private dhe personat e tjerë fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve të ndryshme duhet të bëjnë vetëdeklarimin për plotësimin e kushteve higjieno-shëndetësore në Inspektoratin Sanitar Shtetëror. Gjithashtu, roli i këtij institucioni u plotësua dhe në kuadër të monitorimit, ku sipas ndryshimeve në nenin 13 në fund të shkronjës "b" u shtuan fjalët "edhe treguesit e shëndetit mjedisor, të rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë" dhe në fund të shkronjës "c" shtohen fjalët "si dhe analizën e hazardëve dhe kontrollin në pikat kritike në të gjithë zinxhirin për prodhimin e produkteve ushqimore".

Me anë të Ligjit Nr. 9863 datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar, u shfuqizuan pjesërisht ose plotësisht nenet 13, 19 dhe 20 të Ligjit Nr.7643, datë 2.12.1992 “Për inspektimin sanitar”. Konkretisht:

- Në nenin 13 shkronja "ç", pjesa e fjalisë "kontrollon respektimin e normave higjienike të standardeve shtetërore dhe kushteve teknike të produkteve ushqimore e të artikujve të tjerë, të normave të ushqyerit të grupeve të vecanta të popullsisë, si dhe miraton destinacionin e produkteve ushqimore me skadencë në limit ose të tejkaluar", shfuqizohet;
- Neni 19 paragrafi i parë shfuqizohet, me përjashtim të sapunëve dhe kozmetikës;
- Neni 20 shfuqizohet.

Së fundmi, me anë të Ligjit Nr. 45/2013, u bënë ndryshime lidhur me emërtesën e strukturave të cilat kanë në fokus të veprimtarisë së tyre inspektimin higjieno-sanitar dhe ruajtjen e shëndetit publik ku emërtimi "Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit" zëvendësohet me emërtimin "Ministria e Shëndetësisë"; emërtimi "Instituti Kërkimor i Higjienës dhe Epidemiologjisë" zëvendësohet me emërtimin "Instituti i Shëndetit Publik" dhe emërtimi "Inspektorati Sanitar Shtetëror" zëvendësohet me emërtimin "Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit".

Me anë të këtij ligji, u shfuqizuan nenet 3 dhe 4, ku përcaktoheshin kompetencat për emërimin e inspektorëve të cilët kryenin inspektimin sanitar, nenet 6 dhe 9, të cilat normonin bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të tjera dhe institucionit përgjegjës për kryerjen e inspektimit sanitar, nenet 14,15,16, 23 dhe 24 të cilat normonin mënyrën sesi kryhej inspektimi higjieno-sanitar dhe nenin 34 lidhur me ekzekutimin e gjobës.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemi që kjo politikë synon të rregullojë është lehtësimi i barrës për bizneset për shkak të inspektimit të dyfishtë nga dy institucione të ndryshme për të njëjtin qëllim, si rrjedhojë e mbivendosjes së kompetencave ndërmjet strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Gjithashtu, kjo politikë synon të lehtësojë barrën e strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit sepse, si pjesë të punës, përveç inspektimit shëndetësor dhe inspektimit sanitar jo ushqimor, ka për detyrë, aktualisht, inspektimin dhe monitorimin për zbatim të:

- Ligjit nr. 9518 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”, të ndryshuar;
- Ligjit nr. 9636 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar;
- Ligjit nr. 26/2017 “Për Produktet Kozmetike”;
- Ligjit nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”;
- Ligjit nr.8528, datë 23.9.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gj” të ndryshuar;
- Ligjit nr. 8025, datë 09.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” të ndryshuar.

Shkaqet për këtë mbivendosje kompetencash janë ndërmarrja e reformës në bujqësi dhe miratimi i Ligjit Nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, të cilat përcaktojnë si strukturë përgjegjëse për inspekte në fushën e sigurisë ushqimore Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

Ky problem është i shtrirë në sektorin privat ashtu dhe publik. Grupet e prekura nga shtesat dhe ndryshimet e kësaj politike janë subjektet publike dhe jopublike që operojnë në fushën e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore.

Sipas INSTAT, në fund të vitit 2018 ishin 162 835 ndërmarrje aktive të kategorizuara si më poshtë vijon:

- Bujqësi, pyjet dhe peshkimi 42 099;
- Industria 10 215;
- Ndërtimi 4 602;
- Tregtia 46 643;
- Transporti dhe magazinimi 5 765;
- Akomodimi dhe shërbimi ushqimor 20 185;
- Informacioni dhe komunikacioni 2,974;
- Shërbime të tjera 30,352.

Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit ka gjithsej në të gjithë vendin 202 inspektorë dhe kryen funksionin e tij në 12 qarqet e vendit nëpërmjet degëve rajonale. Mesataria e inspektimeve vjetore është 42 000 mijë inspekte dhe mbulon inspektimin shëndetësor dhe inspektimin sanitar. Inspektimet shëndetësore zënë pjesën më të madhe të

inspektimeve dhe përfshijnë inspektimin e përmbushjes së kriterëve në të tre nivelet e shërbimit parësor, dytësor dhe terciar. Inspektimi shëndetësor përfshin respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shëndetësisë edhe në subjekte jo shëndetësore që nëpërmjet veprimtarisë së tyre ndikojnë në shëndetin publik të popullsisë.

Gjatë vitit 2018 struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit ka kryer 42 046 inspektime dhe monitorime. Sipas tematikës dhe fushës së veprimtarisë këto kategorizohen:

- 83 % e numrit të përgjithshëm ose 34 898 inspektime dhe monitorime janë kryer në fushën shëndetësore dhe sanitare jo në fushën e ushqimit, (në subjekte shëndetësore, arsimore, turistike, kozmetike, në ato të Ministrisë së Rendit, Ministrisë së Mbrojtjes etj)
- Pjesa tjetër e inspektimeve, 17 % ose 7 148 janë inspektime në objektet e prodhimit, të ruajtjes, magazinimit, transportimit e tregtimit të produkteve ushqimore.

Sa më sipër, rreth 7 148 janë inspektime të kryera nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe nëpërmjet kësaj politike synohet të kryhen nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Gjykohet e arsyeshme se rregullimi i inspektimeve të dyfishta dhe përditësimi i kuadrit rregullator është një metodë efektive për arritjen e objektivave të synuar.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Nevoja për ndërhyrje e qeverisë lind nga fakti se kontrolli i kushteve higjieno-sanitare është i nevojshëm për mbrojtjen e shëndetit publik. Megjithatë, gjendja aktuale, ku bizneset që operojnë në fushën e produkteve ushqimore inspektohen në mënyrë të dyfishtë nuk kontribuon në rritjen e cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore pasi kjo e fundit mund sigurohet edhe nëpërmjet inspektimit nga një institucion i vetëm, institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Ndërhyrja që kërkohet nga qeveria është me natyrë rregullatore.

Për të adresuar problemet e përmendura në seksionin e mësipërm, nevojitet që qeveria të ndërhyjë në drejtimet e mëposhtme:

- Në kuadër të saktësimit të kompetencave ndërmjet strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe, lind nevoja të përditësohet togfjalëshi "...nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit ", duke shtuar fjalët "dhe përjashtimisht për fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë".

Kjo do të reflektohet në ndryshimet lidhur me emërtimin dhe fushën e përgjegjësisë së strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit. Ndryshimet në fushën e përgjegjësisë së strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit kanë të bëjnë me përjashtimin nga kompetenca e saj të inspektimit higjieno -sanitar për produktet ushqimorë në objektet e prodhimit, të ruajtjes, magazinimit, transportimit e

tregtimit të produkteve të të gjitha llojeve, duke parashikuar në këtë mënyrë ndarje të kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për inspektimin higjieno-sanitar.

Rrjedhimisht me ndryshimet që kjo politikë synon, struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit nuk do të ketë kompetenca inspektimi higjieno-sanitar për produktet ushqimore në objektet e parashikuara për inspektim sipas ligjit bazë të inspektimit sanitar.

- Ndërhyrja e qeverisë parashikohet gjithashtu dhe në ndryshimin e kundravajtjeve administrative sanitare, të cilat nuk do të konsiderohen shkelje sanitare sipas kësaj politikë, shkeljet si: “falsifikimet ose maskimet në teknologjinë e prodhimit, ruajtjes, transportit e tregtimit të produkteve ushqimore kur këto ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut”; “mosrespektimi i kushteve të prodhimit, sipas kërkesave sanitare që përmban standardi shtetëror ose kushti teknik i produktit ushqimor; “dhe i AZKPK-së (HACCP)”; “tregtimi i produkteve ushqimore jashtë vendeve të lejuara ose pa leje shëndetësore”, “përdorimi i ujërave të zeza për ujitjen e zarzavateve që konsumohen pa përpunim termik paraprak”.
- Si rrjedhojë e ndërhyrjes së qeverisë në shfuqizimin e shkeljeve administrative të mësipërme, gjithashtu do të jetë e nevojshme të ndryshohet kompetenca e strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit që kishin për të vendosur dënime kryesore për kundërvajtjet administrative sanitare të parashikuara më sipër.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*
- Ndarja e qartë e kompetencave ndërmjet strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë brenda vitit 2020 dhe mbrojtja e shëndetit publik nëpërmjet inspektimeve higjieno-sanitare të kryera nga institucionet përgjegjëse.
- Ndërmarrja e procedurave administrative përkatëse për kalimin e inspektorëve nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit te institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë brenda vitit 2020, me qëllim fuqizimin e institucioneve.
- Eliminimi i inspektimeve të dyfishta, brenda vitit 2020, në bizneset që operojnë në fushën e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore, me qëllim lehtësimin e bizneseve nga barra ekonomike dhe sociale.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0, ruajtja e status quo-së implikon mbajtjen në fuqi të ligjit aktual. Ky opsion lë të parregulluar ndarjen e qartë të kompetencave mes dy institucioneve, struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë për inspektimin në objektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore. Ndarja e qartë e kompetencave mes dy

institucioneve ka ardhur si rrjedhojë e reformës në bujqësi dhe ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.

Opsioni 1, hartimi i një ligji të ri. Ky opsion është jo i favorizuar pasi problemet e sipërpërmendura në lidhje me inspektimin e produkteve ushqimore mund të adresohen me ndryshime të ligjit aktual dhe ndërhyrja nuk bën ndryshime thelbësore të ligjit dhe mënyrës së inspektimit.

Opsioni 2, bërja e ndryshimeve në ligjin aktual përfshin ndarjen e qartë të kompetencave për inspektimin higjieno-sanitar ndërmjet strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë lidhur me inspektimet në objektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Subjektet të cilat preken nga kjo politikë janë:

- **Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë;**
- **Bizneset që kanë objekt të veprimtarisë së tyre prodhimin, ruajtjen, magazinimin, transportimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore.**

Ndikime të drejtëpërdrejta

Ndikimet për kategoritë e subjekteve të prekura janë të drejtëpërdrejta.

Ndarja e qartë e kompetencave mes strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, shmang mbivendosjen e kompetencave për inspektimet higjieno sanitare në objektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore. Nëpërmjet ndryshimeve që parashikohen në këtë politikë, në objektet e përcaktuara më sipër, kompetenca e inspektimeve do të kalojë nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit në atë të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, duke lehtësuar ngarkesën e strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit për inspektimin higjieno sanitare në objektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore. Qartësimi i kompetencave kryhet pa cënuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve ushqimore, për rrjedhojë edhe pa cënuar shëndetin publik i cili mbetet prioritet i Qeverisë Shqiptare.

Gjatë vitit 2018 struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit ka kryer 42 046 inspektime dhe monitorime. Sipas tematikës dhe fushës së veprimtarisë këto kategorizohen:

- 83 % e numrit të përgjithshëm ose 34 898 inspektime dhe monitorime janë kryer në fushën shëndetësore dhe sanitare jo në fushën e ushqimit, (në subjekte shëndetësore, arsimore, turistike, kozmetike, në ato të Ministrisë së Rendit, Ministrisë së Mbrojtjes etj).
- Pjesa tjetër e inspektimeve, 17 % ose 7 148 janë inspektime në objektet e prodhimit, të ruajtjes, magazinimit, transportimit e tregtimit të produkteve ushqimore.

Institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë nuk do të ketë shtim të numrit të subjekteve që do të kontrollohen, por vetëm shtim të një Liste Verifikimi (check list). Ndikimet që rrjedhin nga kjo politikë janë vetëm pozitive dhe nuk ka asnjë efekt financiar shtesë.

Eliminimi i inspektimeve të dyfishta nuk reflekton kursime në buxhetin e shtetit pasi nuk do të ketë ulje të numrit të inspektorëve por kalim të inspektorëve nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit tek institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Po kështu edhe për bizneset që kanë objekt të veprimtarisë së tyre prodhimin, ruajtjen, magazinimin, transportimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore do të ketë ndikim pozitiv pasi do të lehtësohen nga barra e inspektimeve të dyfishta nga dy institucione të ndryshme për të njëjtin qëllim, për ruajtjen e sigurisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore.

Ndikime jo të drejtëpërdrejta

Impakti shëndetësor

Inspektimet higjieno sanitare kanë si qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullsisë nga faktorët e dëmshëm për shëndetin dhe pasojat që rrjedhin prej tyre. Qartësimi i kompetencave mes strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë kryhet pa cënuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve ushqimore, për rrjedhojë edhe pa cënuar shëndetin publik i cili mbetet prioritet i Qeverisë Shqiptare.

Nëpërmjet lehtësimit të barrës inspektuese që aktualisht është e dyfishtë për bizneset që operojnë në fushën e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore, kjo politikë mund të rezultojë në pakësimin e dënimeve me gjobë të vendosura si rrjedhojë e shkeljeve administrative sanitare. Megjithatë nuk mund të përlogaritim paraprakisht nëse do të ketë pakësim të masave të dënimeve me gjobë për bizneset aktualisht aktive si edhe nëse do të ketë shtim të regjistrimit të bizneseve që operojnë në këtë fushë si pasojë e lehtësimit nga inspektimet.

Kufizimet e analizës

Analiza e mësipërme vlerësohet të mos ketë limite por ka avantazhet e mëposhtëme:

- Ndarja e qartë e kompetencave mes strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë;
- Shmangia e inspektimeve të dyfishta në bizneset që kanë objekt të veprimtarisë së tyre prodhimin, ruajtjen, magazinimin, transportimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore.

Si konkluzion, efektet e pritshme nga zbatimi i kësaj politike pritet të jenë pozitive.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Analiza me shumë kritere

Opsionet që merren në konsideratë janë:

- *Opsioni 0 - Të ruhet ligji aktual për inspektimin sanitar*
- *Opsioni 1 – Të hartohet një ligj i ri për inspektimin sanitar*
- *Opsioni 2 – Të bëhen shtesa dhe ndryshime në ligjin aktual për inspektimin sanitar.*

Kriteret për vlerësimin e opsioneve dhe pesha e secilit sipas rëndësisë relative

o Mbrojtja e shëndetit publik 2

o Hartimi dhe implementimi i politikës në një kohë të shkurtër 3

o Potenciali për të minimizuar koston financiare që përballon biznesi 1

o Potenciali për të reduktuar dëmin moral që u shkaktohet bizneseve (burimeve njerëzore përgjegjëse për menaxhimin) si pasojë e inspektimeve të dyfishta 4

o Shpërndarja proporcionale e inspektimeve ndërmjet institucioneve përgjegjëse 4

o Fuqizimi i strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë 2

Shkalla e performancës është nga 0 në 5, ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2
Mbrojtja e shëndetit publik	2	5 (10)	5 (10)	5 (10)

Hartimi dhe implementimi i politikës në një kohë të shkurtër	3	5 (15)	0 (0)	4 (12)
Potenciali për të minimizuar koston financiare që përballon biznesi	1	0 (0)	5 (5)	5 (5)
Potenciali për të reduktuar dëmin moral që u shkaktohet bizneseve (burimeve njerëzore përgjegjëse për menaxhimin) si pasojë e inspektimeve të dyfishta	4	0 (0)	5 (20)	5(20)
Shpërndarja proporcionale e inspektimeve ndërmjet institucioneve përgjegjëse	4	0 (0)	3 (12)	5 (20)
Fuqizimi i strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë	2	0 (0)	2 (4)	3 (6)
Pikët		25	51	73

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Zbatimi i ligjit është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë së tyre, të specializuara për monitorimin e këtij ligji, konkretisht, struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Kjo politikë vlerësohet të mos ketë pengesa për realizimin e saj.

Si rrjedhojë e ndarjes së kompetencave ndërmjet institucioneve, institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë nuk do të ketë shtim të numrit të subjekteve që do të inspektojnë, por vetëm shtim të një Liste Verifikimi (check list).

Numri i inspektorëve që do të kalojë nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit tek institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë do të kryhet në bazë të vlerësimit të përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ky vlerësim do të bazohet në volumin e punës së shtuar si rrjedhojë e riorganizimit të institucioneve,

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Me miratimin e kësaj politike do të ketë një ndarje të qartë të kompetencave, për rrjedhojë monitorimi i inspektimeve në objektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe

tregtimit të produkteve ushqimore do të kryhet nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Arritja e qëllimeve do të matet me anë të treguesve të mëposhtëm:

- o Numri i inspektimeve të kryera në objektet e prodhimit, ruajtjes, magazinimit, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore që do të kryhen nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë;
- o Frekuenca e masave administrative të vendosura në bizneset që kanë në fushën e veprimtimit prodhimin, ruajtjen, magazinimin, transportimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore;

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

MINISTËR

OGERTA MANASTIRLIU